



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS

Divizioni i Rrjetit & Divizioni i Furnizimit

Procedura: Procedura e përkohshme për leximin dhe faturimin e konsumatorëve me Grupe matëse (me maksigraf)

Data : 31.08.2006

Pregaditur : Selman Hoti, Hysni Gashi, Enver Gashi

Shqyrtuar : Arif Vitija , Vehbi Salihu , Arbnore Ibrahim

Aprovuar : Fillanza Hoxha, Fëllanze Pula

Referenca : IR – 01 – 2006

Qëllimi

Kjo procedurë e përkohshme obligon të dy Divizionet për leximin dhe faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorët e niveleve 110 kV , 35 kV, 10 kV dhe 04 kV shkalla e parë, pra Grupi matëse (me maxigraf). Kjo procedure është bazuar në Kapitullin 7 Neni 20 Të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji (KPF) të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së dhe ka për qëllim krijimin e kushteve për avancimin e leximit dhe faturimit të këtij grupi të konsumatorëve.

Procedura në fjalë do të aplikohet deri në aplikimin e Marrëveshjes për Kyçe në Rrjetin e Shpërndarjes që palët janë të obliguar të nënshkruajnë sipas nenit 32.9 të Rregullit për kushte të përgjithshme për furnizim me energji (KPF) dhe Kodit të Matjes të paraparë me Ligjin mbi Energjinë Elektrike.

Kapitulli 1: Leximi

Neni 1

Leximi i Gr.matëse (me maxigraf) do të bëhet nga ekipet e leximeve të Operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Neni 2

Leximi i Gr.matëse (me maxigraf) do të bëhet në formë periodike një mujore, data e leximit të Grupit Matës (me maksigraf) do ti bëhet e njohur konsumatorit përmes divizionit të furnizimit dhe kjo datë e leximit do të respektohet nga operatori i sistemit përveq rasteve të festave zyrtare dhe ditëve të vikendeve.

Neni 3

- 3.1 Perioda e leximit do të filloj me 10 të muajit aktual dhe do të përfundoj me datën 08 të muajit vijues për shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës paraprake të përcaktuar në nenin 2 të kësaj procedure. Gjatë kësaj periode duhet të lexohen të gjithë konsumatorët me Gr.matëse (me maxigraf).
- 3.2 Datat e leximeve për secilin konsumator do të jenë po ato të leximit të parë, përveq të rasteve të përshkruara në nenin 2 të kësaj procedure.
- 3.3 Konsumatorët 110 kV lexohen me datën 01 të çdo muaji prej orës 08 - 09. Leximin e bënë personeli në ndërrimin e parë në TS në prezencën e konsumatorit, gjendjet i verifikon dhe i merr ekipi i lexuesve
- 3.4. Gjendjet e konsumatorëve 110 kV (Sharrit , Trepçes Ferronikelit etj.) dorëzohen deri me datën 03 të muajit aktual.

Neni 4

Listat e leximit BIO-01 nga CCP-ja dorëzohen dhe pranohen me specifikim nga personat përgjegjës të dy Divizioneve përmes formularëve gjegjës, nga Përgjegjësi i Faturimit në Divizionin e Furnizimit dhe Përgjegjësi i Leximit të Grupit Matës në Divizionin e Rrjetit.

Neni 5

Leximet e kryera parçialisht (çdo distrikt veq e veqë) i dorëzohen Divizionit të Furnizimit çdo 4 apo 6 ditë punë me nënshkrim të dyanshëm në formularët gjegjës nga persona të cekur me lartë.

Neni 6

Leximi do të bëhet në Proceset e Leximit në 3(tri) kopje nga do të bartet në Listat e leximeve të përgaditura nga ana e Divizionit të Furnizimit dhe këto Lista së bashku me një kopje të proceseve të përgaditura nga ana e Divizionit të Rrjetit (Shërbimi i Lexuesve), i dorëzohen Shërbimit të Faturimit në Divizionin e Furnizimit.

Neni 7

Përgjegjësi i Lexuesve ka për obligim të informojë konsumatorin dhe Divizionin e Furnizimit Departamentin e Perkuqjesit ndaj konsumatorëve për pa rregullsit teknike që i vëren në piken matëse, si dhe ndërrimet eventuale në pikat matëse edhe atë me shkrim.

Neni 8

Në rastë të pamundësisë së leximit, mos funksionimit të paisjeve matëse Ekipi i Leximit jep me shkrim proqesin adekuat përgjegjësit të faturimit dhe në bashkëpunim me përgjegjësën e Leximit vendosin për formën e faturimit për muajin aktual të energjis dhe fuqin maksimale për faturim. Faturimi i konsumatorit do të jetë konform të dispozitave të Rregullit të KPFE.

Kapitulli 2: Faturimi

Neni 9

Faturimi i këtyre leximeve do të bëhet nga Divizioni i Furnizimit - Shërbimi përkatës pasi të dorëzohen nga ana e Divizionit të Rrjetit - Shërbimit përkatës.

Neni 10

Divizioni i Furnizimit është i detyruar të siguroj që konsumatorët janë të faturuar për energjinë e konsumuar dhe për taksat tjera të aplikueshme me tarifën e aprovuar nga ZRRE-ja.

Neni 11

Personeli i faturimit do të bënë radhitjen e konsumatorëve në shteg-BIO-01 sipas sygjërimeve të personelit të Leximeve pamvarësisht nga Grupi Tarifor.

Neni 12

Shpërndarja e faturave do të bëhet përmes Divizionit të Furnizimit.

Neni 13

Analizat teknike të leximit do të bëhen nga Divizioni i Furnizimit - shërbimi përkatës.

Kapitulli 3: Mbyllja e shtegut dhe kontestet

Neni 14

Para mbylljes së shtegut për çdo rast kontestues që vërehet duhet të konsultohen përgjegjësi i Faturimit me atë të Leximit - me qëllim të evitimit të dilemave rrethë sasisë së energjisë dhe fuqisë maksimale të faturimit .

Neni 15

Pasi të jet mbyllur shtegu Raportet teknike nga CCP-ja dërgohen në Divizionin e Rrjetit – Përgjegjësit të lexuesve.

Kapitulli 4: Dispozitat e përgjithshme

Neni 16

Çdo reklamim që dikton korigjimin e sasisë teknike në kW apo kWh (pas perfundimit të faturimit)nuk mund të bëhet pa pelqimin e personelit përgjegjës të Departamentit të Leximit dhe Faturimit .

Neni 17

Në qoftë se gjatë zbatimit të kësaj procedure paraqiten vështirësi të natyrës që reflektojnë në realizimin efikas të detyrave të percaktuara kjo procedurë mund të plotësohet ose të ndryshohet me aprovimin paraprak nga ZRRE-ja . Me plotësimet dhe ndryshimet eventuale para zbatimit Divizioni i Shpërndarjes(Rrjetit) është i obliguar të njoftoj konsumatorët subjekt të kësaj procedure.

Neni 18

Kjo procedurë e përkohshme hynë në fuqi nga momenti i aprovimit nga Bordi i ZRRE-së.

Shtojcë:

- **Kësaj procedure i bashkangjiten si shembull forma e specifikimit të pranimit-dorëzimit të leximeve (Shtojcë 1) .**
- **Formulari BIO-01 (Shtojcë 2)**

Me _____ Prishtinë

Fllanza Hoxha
Drejtor ekzekutiv i div.Rrjetit

Fellanze Pula
Drejtor ekzekutiv i div.Furnizimit

Shtojcë 1

Specifikimi i dorëzimit të fletëleximeve për Lexim

Distrikti	Gr tar	Nr .i kons. Aktivë	Nr .i kons. Pasivë	Gjithësejtë	Vërejtjet eventuale
Prishtinë	1/2 - 35 kV	4	1	5	
	1/3 – 10 kV	42	18	60	
	6/6 04 kV I	158	16	174	

Fletë leximet u dorëzuan për evidentimin e shenimeve më dd-m-v _____

Dorëzojë Nr i punës _____ Pranojë Nr i punës _____

Specifikimi i kthimit të fletëleximeve në Faturim

Distrikti	Gr tar	Nr .i kons. të Lexuar	Nr .i kons. të palexuar	Lecim i vlersuat te Maksi. apo kWh	Gjithësejtë
Prishtinë	1/2 - 35 kV	3	1	1	5
	1/3 – 10 kV	40	18	2	60
	6/6 04 kV I	150	16	8	174

Fletë leximet u kthyen për Faturim më dd-m-v _____

Dorëzojë Nr i punës _____ Pranojë Nr i punës _____
